



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 35 regjistër (JR)  
Datë 23.11.2018

Nr. 17 i vendimit  
Datë 25.07.2019

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Ina Rama</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Relator</b>
<b>Luan Daci</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 25.07.2019, ora 13:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier De Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 35/2018 (JR), datë 23.11.2018, që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 65, datë 13.09.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Bala (Pajo).

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Bala (Pajo).

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 65, datë 13.09.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Bala (Pajo).

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b i Kushtetutës; jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese; nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve

në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për ngritjen dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurave Administrative.

### **Trupi gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoji Komisionerin Publik, i cili përfundimisht, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 65, datë 13.09.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Valbona Bala (Pajo), duke vendosur në pjesën urdhëruese të këtij vendimi ndalimin e emërimit në organet e drejtësisë<sup>1</sup> për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimit të nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, znj. Valbona Bala (Pajo), e cila përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit, duke hequr nga pjesa arsyetuese e tij ndalimin e parashikuar në nenin G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

### **VËREN:**

#### **I. Rrethanat e çështjes**

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Bala (Pajo), ka ushtruar funksionin e këshilltares pranë Njësisë së Shërbimit Ligjor<sup>2</sup> të Gjykatës Kushtetuese, prej datës 18.04.2008 deri më datë 30.04.2017. Bazuar në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës, të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese duhet të rivlerësohen *ex officio*. Ky rivlerësim kryhet nga Komisioni, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin nr. 84/2016.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Në datën 31.03.2017, znj. Valbona Bala (Pajo) ka paraqitur para Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese dorëheqjen e saj nga detyra e këshilltares pranë kësaj gjykate. Bazuar në këtë akt dorëheqjeje, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, në ushtrim të kompetencave të tij të parashikuara në nenin 12, pika 2, nënpika “d” e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionim e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka nxjerrë urdhrin nr. 11{\*\*\*}, datë 20.04.2017, “Për lirim nga detyra dhe përfundimin e marrëdhënieve të punës” për znj. Valbona

<sup>1</sup> Pozicionet e përcaktuara shprehimisht sipas nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës për të cilat ndalohet emërimi i subjektit të rivlerësimit që ka dhënë dorëheqjen nga detyra janë: gjyqtari ose prokurori i çdo niveli, anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm.

<sup>2</sup> Njësia e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese funksionon si njësi me këtë emërtesë nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 99/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Bala (Pajo), me efekt nga data 30.04.2017, sipas kërkesës së vetë subjektit të rivlerësimit. Nga kjo datë e në vijim, znj. Bala ushtron veprimtarinë e saj profesionale si këshilltare ligjore pranë një organizate ndërkombëtare.

4. Më datë 17.04.2018, subjekti i rivlerësimit i ka drejtuar Komisionit një shkresë me lëndë “Përditësim të dhënash”, me anë të së cilës e njoftonte Komisionin se si pasojë e dorëheqjes së dhënë nga pozicioni i këshilltarit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të dhënat e kontaktit të deklaruara në formularin e vetëvlerësimit nuk janë më të disponueshme, duke i vënë në dispozicion në të njëjtën kohë, për çdo nevojë komunikimi në vijim të procesit të rivlerësimit, adresën e saj elektronike private.
5. Më datë 25.06.2018, subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Bala (Pajo), i drejton Komisionit një kërkesë për qartësimin e pozicionit të saj në procesin e rivlerësimit, në kushtet kur ajo: (i) nuk është më në detyrë si pasojë e dorëheqjes së saj; (ii) ka shprehur vullnetin për të vijuar procesin e rivlerësimit; (iii) për shkak të rezultateve të testimit pranë Shkollës së Magjistraturës, ka humbur të drejtën për të vijuar trajnimin fillestar pranë kësaj shkolle dhe karrierën si magjistrate.
6. Më datë 27.06.2018, subjekti i rivlerësimit i drejton një tjetër shkresë Komisionit, me anë të së cilës shprehet se i vë këtij të fundit në dispozicion informacionin e kërkuar (aktin e dorëheqjes si dhe urdhrin nr. {\*\*\*}, datë 20.04.2017, të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese “Për lirimin nga detyra dhe përfundimin e marrëdhënies së punës”), si dhe sqaron statusin e saj ligjor për efekt të rivlerësimit, duke nënvizuar faktin se ky komunikim nuk ka për qëllim refuzimin dhe as shmangien nga procesi i rivlerësimit.
7. Në rrethanat e mësipërme, Komisioni ndërpreu procesin e rivlerësimit kalimtar të znj. Valbona Bala (Pajo), me vendimin nr. 65, datë 13.09.2018.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

8. Komisioni me vendimin nr. 65, datë 13.09.2018, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës vendosi:
  1. *Të ndërpresë procesin e rivlerësimit kalimtar të znj. Valbona Bala (Pajo).*
  2. *Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.*
  3. *Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*

## **III. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik**

9. Komisioneri Publik Florian Ballhysa, më datë 05.10.2018, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 65, datë 13.09.2018, për subjektin e rivlerësimit, znj. Valbona Bala (Pajo), duke

pretenduar se vendimi i Komisionit është i padrejtë, për shkak se procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit duhej të ndërpritej vetëm në zbatim të plotë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, përfshirë edhe ndalimin e parashikuar në pikën 2 të këtij neni.

10. Komisioneri Publik i kërkoi Kolegjit marrjen në shqyrtim të shkaqeve të ngritura në ankim dhe në përfundim të gjykimit, në zbatim të nenit 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, të vendosë *ndryshimin e vendimit nr. 22, datë 07.06.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*
11. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

**11.1** *Komisioni nuk ka argumentuar në mënyrë shteruese natyrën specifike të statusit që gëzon subjekti i rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, nuk ka bërë cilësimin e saktë të situatës ligjore.* Komisioneri pretendon se referuar akteve të fashikullit, si dhe arsyetimit të Komisionit, është i paqartë shkaku ligjor që ka shërbyer për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit në fjalë.

**11.2** *Komisioni nuk ka mbajtur parasysh në këtë vendimmarrje orientimin e dhënë nga Kolegji, me vendimin e tij nr. 1/2018 (JR), në zbatim të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në drejtim të:*

- (i) *verifikimit të vullnetit të lirë dhe të pavesuar të subjektit të rivlerësimit për dorëheqje;*
- (ii) *verifikimit të rrethanave konkrete nëse jemi para rastit përjashtimor kur nuk mbahet seancë dëgjimore me subjektin e rivlerësimit; si dhe*
- (iii) *sa i takon zbatimin të parashikimit të plotë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.*

#### **IV. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit**

12. Subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Bala (Pajo), më datë 05.10.2018, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 65, datë 13.09.2018, duke pretenduar se ky vendim është marrë në cenim të së drejtës së subjektit për një proces të rregullt ligjor dhe si pasojë e interpretimit të gabuar të statusit të subjektit, sipas Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
13. Subjekti i rivlerësimit i kërkoi Kolegjit që të marrë në shqyrtim shkaqet e ngritura në ankim dhe që në përfundim të gjykimit të vendosë *ndryshimin e vendimit të Komisionit në pjesën që arsyeton zbatimin e masës ndaluese për 15 vjet, duke qartësuar kështu në mënyrë përfundimtare pozitën e subjektit në procesin e rivlerësimit kalimtar, në raport me Kushtetutën dhe ligjin nr. 84/2016.*
14. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

**14.1** *Lidhur me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, subjekti pretendon cenim të së drejtës për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore, cenim të standardit të arsyetimit të vendimit, si dhe cenim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj.*

**14.2** *Lidhur me themelin e çështjes, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka përcaktuar në mënyrë të gabuar pozitën ligjore në të cilën ndodhej subjekti në raport me procesin e rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenin G të Aneksit të Kushtetutës.*

**14.3** Lidhur me argumentimin për zbatimin e masës ndaluese për emërim për 15 vjet në organet e drejtësisë<sup>3</sup>, në pjesën arsyetuese të vendimit të Komisionit, subjekti i rivlerësimit pretendon se për një subjekt, i cili nuk gëzon statusin e magjistratit, vendosja e një ndalimi të tillë është joproporcional.

## V. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

### A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

#### a) Juridiksioni i Kolegjit

15. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin, znj. Valbona Bala (Pajo), dhe për të cilin Komisioneri Publik dhe subjekti i rivlerësimit nëpërmjet ankimit kërkojnë ndryshimin e tij, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

#### b) Legjitimimi i ankuesve

16. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>4</sup>, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.
17. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>5</sup>, nga

<sup>3</sup> Referoju pozicioneve të përcaktuara shprehimisht në pikën 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës dhe të përmendura në poshtëshënimin 1 të këtij vendimi.

<sup>4</sup> Siç rezulton nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 65, datë 13.09.2018 për rivlerësimin e subjektit, znj. Valbona Bala (Pajo), i është njoftuar Institucionit të Komisionerit Publik më datë 20.09.2018, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 19.09.2018, konfirmuar sipas lajmërim-marrjes së protokolluar me nr. {\*\*\*} prot., datë 20.09.2018, si dhe ankimi i Komisionerit Publik është depozituar pranë Komisionit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 05.10.2018, protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*}, datë 05.10.2018, që rezulton të jetë dita e 15-të e afatit ligjor për të ushtruar ankim në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit 84/2016.

<sup>5</sup> Siç rezulton nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 65, datë 13.09.2018, për rivlerësimin e subjektit Valbona Bala, i është njoftuar subjektit më datë 19.09.2018, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., të së njëjtës datë, konfirmuar sipas lajmërim-marrjes më datë 24.09.2018, kurse ankimi i subjektit të rivlerësimit është depozituar pranë Komisionit më datë 05.10.2018, protokolluar në të njëjtën datë me nr. {\*\*\*}, që rezulton të jetë dita e 11-të e afatit ligjor për të ushtruar ankim, në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

*c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

18. Në kushtet kur ndaj vendimit të Komisionit nr. 65, datë 13.09.2018, kanë ushtruar ankim pranë Kolegjit, Komisioneri Publik dhe subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues, në përputhje me dispozitat e neneve 448 dhe 461 të Kodit të Procedurës Civile vendosi t'i bashkojë këto dy ankime dhe t'i gjykojë në një proces të vetëm.
19. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik dhe atë të subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Bala (Pajo), ndaj vendimit të Komisionit nr. 65, datë 13.09.2018, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të palëve.

*B. Mbi themelin e pretendimeve sipas shkaqeve të ankimeve të Komisionerit Publik dhe të subjektit të rivlerësimit.*

20. *Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore, cenim të standardit të arsytimit të vendimit dhe cenim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj; si dhe pretendimit të Komisionerit Publik për vendimmarrje të Komisionit në mosrespektim të orientimit të dhënë nga Kolegji në zbatim të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në vendimin e tij nr. 1/2018 (JR), në drejtim të:*
  - *verifikimit të vullnetit të lirë dhe të pavesuar të subjektit të rivlerësimit për dorëheqje;*
  - *verifikimit të rrethanave konkrete nëse jemi para rastit përjashtimor kur nuk mbahet seancë dëgjimore me subjektin e rivlerësimit;*

trupi gjykues konstaton se:

- *Në lidhje me pretendimin e subjektit për cenim të së drejtës për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore*

**20.1** Subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Bala pretendon se Komisioni ka cenuar të drejtën e saj për proces të rregullt ligjor pasi ka vendosur kryesisht për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, pa respektuar të drejtën e saj për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore dhe parashtrimit prej saj të argumenteve në kuadër të realizimit të mbrojtjes efektive të të drejtave.

**20.2** Komisioneri Publik gjithashtu pretendon se Komisioni në procedurën për marrjen e vendimit për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin në fjalë nuk ka mbajtur parasysh orientimet e dhëna nga Kolegji në paragrafët 54 dhe 55 të vendimit nr. 1/2018 (JR) në drejtim të verifikimit të rrethanave konkrete, nëse jemi para rastit përjashtimor kur nuk mbahet seancë dëgjimore me subjektin e rivlerësimit.

**20.3** Komisioni në vendimin e tij nuk shprehet në asnjë moment lidhur me të drejtën e subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Bala për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore, apo rrethanat të cilat justifikojnë përjashtimin e saj nga kjo e drejtë, sikundër as në pjesën ku referohet baza ligjore në të cilën mbështet vendimi i dhënë nuk referohet asnjë dispozitë ligjore në këtë drejtim.

**20.4** Në shqyrtim të këtyre pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për cenim të së drejtës për t'u dëgjuar, si dhe të atij të Komisionit Publik në drejtim të një vendimmarrjeje të Komisionit në moszbatim të vendimeve orientuese të Kolegjit, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të çështjes, trupi gjykues konstaton se për shqyrtimin e çështjes në fjalë nuk është mbajtur seancë dëgjimore nga Komisioni me subjektin e rivlerësimit, znj. Valbona Bala, si dhe rrethanat e rastit në fjalë nuk e klasifikojnë atë si një nga rastet e përcaktuara shprehimisht në nenin 89 të Kodit të Procedurës Administrative, ku procedura administrative mund të mbyllet pa njoftuar dhe pa i dhënë mundësinë palës për t'u dëgjuar.

**20.5** Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se mosmbajtja e seancës dëgjimore nga Komisioni, në kundërshtim me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe në mungesë të rasteve përjashtimore të përcaktuara në mënyrë shteruese në nenin 89 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilave procedura administrative mund të mbyllet pa nevojën e njoftimit të subjektit dhe pa i dhënë mundësinë këtij të fundit për t'u dëgjuar lidhur me kërkesën e tij, vlerësohet si mosrespektim nga ana e Komisionit i të drejtës së subjektit për t'u dëgjuar, si një ndër elementet e procesit të rregullt në shqyrtimin e çdo çështjeje që sjell pasoja të drejtpërdrejta mbi statusin e tij ligjor. Gjithashtu, kjo sjellje procedurale e Komisionit vlerësohet se cenon edhe transparencën e procesit të rivlerësimit, i cili në themelin e tij ka nevojën e rikthimit të besimit të publikut tek institucionet e sistemit të drejtësisë<sup>6</sup>.

◦ *Në lidhje me pretendimin e subjektit për cenim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*

**20.6** Subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Bala, në ankimin e saj pretendon se nga Komisioni nuk është respektuar as standardi kushtetues i arsytimit të vendimit me anë të të cilit është vendosur ndërprerja e procesit të rivlerësimit, pasi në vendimin e Komisionit, sipas saj, konstatohen paragrafë të cilëve u mungon lidhja shkak-pasojë, u mungon arsytimi i thellë e i shëndoshë logjik, u mungon analiza kushtetuese për të arritur bindshëm në përfundimin e shprehur në pjesën urdhëruese të vendimit.

**20.7** Komisioneri gjithashtu në ankimin e tij ngre pretendimin se referuar gjendjes së akteve dhe arsytimit të vendimit, është i paqartë shkak ligjor që ka shërbyer për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit për subjektin e rivlerësimit, znj. Valbona Bala, dhe arsyeja se pse nuk është zbatuar i plotë neni G i Aneksit të Kushtetutës.

**20.8** Komisioni në vendimin e tij arsyeton<sup>7</sup>: *Sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës, kuptohet qartë se pasoja e dorëheqjes nga funksioni si këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese nga ana e subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Bala (brenda tre muajve që ligji kishte hyrë në fuqi), është*

<sup>6</sup> *Injēti qëndrim është mbajtur nga Kolegji edhe në vendimin e tij nr. 5/2018 (JR) (shih paragrafët 28 dhe 29).*

<sup>7</sup> *Shih paragrafin e tretë të pikës 1 në f. 3 të vendimit të Komisionit.*

*ndërprerja e procesit të rivlerësimit (neni G, pika 1) dhe ndalimi i emërimit të saj në një prej funksioneve gjyqtar ose prokuror i çdo niveli etj. për një periudhë 15-vjecare (neni G, pika 2).*

**20.9** Në shqyrtim të pretendimeve të mësipërme të ankuesve, trupi gjykues mban në konsideratë jurisprudencën<sup>8</sup> e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, e cila thekson domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Kjo gjykatë ka vlerësuar se arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Ajo arsyeton se vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Vendimet përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Gjykata verifikon nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërcituara.

**20.10** Në kuadër të sa më sipër, trupi gjykues në vlerësim të pretendimeve të ankuesve sa i takon qartësisë së arsytimit të vendimit të Komisionit dhe bazueshmërisë së tij në ligj dhe në aktet e administruara gjatë procesit për subjektin në fjalë, arrin në këto përfundime:

**20.11** Komisioni në vendim (në kuptim edhe të faktit që vendimi përbën dhe aktin procedural kryesor) nuk rezulton të ketë bërë një analizë juridike të aktit të dorëheqjes së subjektit, i cili duket të jetë dhe shkaku ligjor që ka çuar Komisionin në vendimin objekt shqyrtimi, sikundër nuk rezulton të ketë arsyetuar as në drejtim të faktit nëse kjo dorëheqje do të trajtohet sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës apo nenit 56 të ligjit nr. 84/2016.

**20.12** Komisioni është i paqartë në arsytimin e tij në lidhje me dispozitën ligjore, e cila ka shërbyer për vlerësimin e aktit të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, sa kohë në paragrafin e tretë të pikës 1 të arsytimit, teksa referon pasojat e dorëheqjes sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës, shprehet se dorëheqja e subjektit të rivlerësimit është dhënë brenda tre muajve që ligji kishte hyrë në fuqi, një kriter ky, i cili është përcaktues në drejtim të identifikimit të bazës ligjore për trajtimin dhe vlerësimin e aktit të dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit, sipas nenit 56 të ligjit nr. 84/2016.

**20.13** Në vendimin e Komisionit vihet re një mospërputhje mes pjesës së arsytimit të vendimit, në pjesën ku Komisioni shprehet se pasoja e dorëheqjes sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës është ndalimi i emërimit të subjektit në një prej funksioneve të përmendura në pikën 2 të këtij neni dhe pjesës urdhëruese të vendimit, sipas të cilit Komisioni ka disponuar vetëm mbi ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar, sipas nenit G, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, edhe pse baza ligjore citohet të jetë neni G i saj (në tërësinë e tij). Ky moment qartazi dëshmon jo vetëm

---

<sup>8</sup> Shih vendimet nr. 3, datë 26.01.2015, nr. 63, datë 23.09.2015, nr. 24, datë 25.04.2016, nr. 73, datë 16.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese.



mosrespektimin nga ana e Komisionit të orientimit të dhënë nga Kolegji<sup>9</sup> në drejtim të përfshirjes në pjesën urdhëruese të vendimit të ndalimit të ushtrimit të funksioneve nga ana e subjekteve të rivlerësimit në rastet e ndërprerjes së procesit sipas kësaj dispozite, por e bën vendimin e Komisionit të cenueshëm në drejtim të standardit të arsytimit, si pasojë e mospërputhjes mes pjesës urdhëruese të vendimit dhe arsytimit të Komisionit në marrjen e këtij vendimi.

Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se arsytimi i vendimit të Komisionit nr. 65, datë 13.09.2018, ka cenuar standardin kushtetues të arsytimit të një vendimi gjyqësor.

° *Në lidhje me pretendimin për cenim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj*

**20.14** Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është marrë në tejkalim të kompetencave ligjore, për sa kohë ky organ ka marrë kryesisht iniciativën për të ndërprerë procesin e rivlerësimit, ndërkohë që kjo është një e drejtë ekskluzive e subjektit të rivlerësimit, e shprehur përmes vullnetit të lirë dhe të pavesuar, si në formë, ashtu edhe në përmbajtje.

**20.15** Në referencë të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, por edhe asaj të GjEDNj-së, është vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 6 të KEDNj-së dhe nenit 42 të Kushtetutës është edhe shqyrtimi i çështjes nga një *gjykatë e caktuar me ligj*. Ky nocion, referuar jurisprudencës së sipërcituar karakterizohet në kuptimin material, nga roli i saj gjyqësor, d.m.th., të zgjidhë çdo çështje që është në kompetencën e saj, në bazë të normave të së drejtës, me juridiksion të plotë dhe në përfundim të një procedure të caktuar (*Qipro kundër Turqisë*<sup>10</sup> [GC], paragrafi 233; *Sramek kundër Austrisë*<sup>11</sup>, paragrafi 36).

**20.16** Në këtë kuptim, në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit për cenim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, si pasojë e vendimmarrjes së Komisionit për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kryesisht, në mungesë të ekzistencës së vullnetit të subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim, trupi gjykues në analizë të dispozitave ligjore të cilat përcaktojnë kompetencat e institucioneve të rivlerësimit, konkretisht nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenit Ç, pika 3 dhe nenit G të Aneksit të Kushtetutës arrin në përfundimin se për sa kohë kryerja e procesit të rivlerësimit është kompetencë e Komisionit, edhe ndërprerja e këtij procesi, si pasojë e ekzistencës së shkakut ligjor të parashikuar shprehimisht në nenin G të Aneksit të Kushtetutës (dorëheqja nga detyra e subjektit të rivlerësimit) është kompetencë kushtetuese dhe ligjore e tij, në kushtet kur është përmbushur edhe kriteri kohor<sup>12</sup>, sipas të cilit dorëheqja duhet të jetë dhënë përpara përfundimit të procesit të rivlerësimit. Verifikimi nga ana e Komisionit i dorëheqjes së dhënë nga subjekti i rivlerësimit dhe miratimit të saj nga organi kompetent, nëpërmjet informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë<sup>13</sup> dhe tërhequr prej

<sup>9</sup> Shih paragrafin 97 të vendimit të Kolegjit nr. 1/2018 (JR).

<sup>10</sup> [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-59454"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

<sup>11</sup> [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-57581"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

<sup>12</sup> Sipas interpretimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës në arsyetimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 78, datë 12.12.2017 (shih paragrafin 43 të vendimit të Gjykatës Kushtetuese).

<sup>13</sup> Nëpërmjet shkresës së Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. {\*\*\*} prot., datë 27.06.2018.

këtij të fundit nga Gjykata Kushtetuese<sup>14</sup>, vlerësohet nga trupi gjykues si procedurë e vlefshme dhe e kryer në kuadër të parashikimeve të nenit Ç, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, ndërprerja e procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit nuk vlerësohet se është kryer në tejkalim të kompetencave të tij ligjore, por përkundrazi, në përmbushje të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, si pasojë e dorëheqjes nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Bala (Pajo), sipas vullnetit të saj dhe konfirmuar zyrtarisht nëpërmjet institucioneve shtetërore. Në vijim të analizës së mësipërme, trupi gjykues arrin në përfundimin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për cenim të parimit të *gjykatës së caktuar me ligj* nuk është i bazuar.

**20.17** Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues konstatoi se Komisioni nuk ka respektuar të drejtën e subjektit për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore lidhur me ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, çështje kjo që sjell pasoja të drejtpërdrejta mbi statusin e tij ligjor, si dhe ka cenuar standardin e arsytimit të vendimit të dhënë në këtë rast. Trupi gjykues i trajtoi këto gabime procedurale të Komisionit në kuadër të parashikimeve të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, duke i korigjuar, njëherazi duke i garantuar subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Bala (Pajo) të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në mënyrë efektive përpara një gjykate të pavarur dhe të paanshme lidhur me të gjitha pretendimet e saj mbi procesin e rivlerësimit, të cilat do të duhej t'i kishte dhënë përpara Komisionit, si dhe duke e dëgjuar mbi ankimin e saj dhe ankimin e Komisionerit Publik.

- 21.** *Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka përcaktuar në mënyrë të gabuar pozitën ligjore në të cilën ndodhej subjekti në raport me procesin e rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenin G të Aneksit të Kushtetutës; si dhe në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik se Komisioni, si pasojë e mosargumentimit në mënyrë shteruese të natyrës specifike të statusit që gëzon subjekti i rivlerësimit, nuk ka bërë cilësimin e saktë të situatës ligjore, për rrjedhojë referuar akteve të fashikullit, si dhe arsytimit të Komisionit, ky i fundit ka qenë i paqartë në identifikimin e shkakut ligjor që ka shërbyer për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin në fjalë, si dhe në arsyen se pse nuk është zbatuar i plotë neni G i Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues konstaton se:*

**21.1** Referuar akteve të fashikullit të çështjes, në momentin e hyrjes në fuqi<sup>15</sup> të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, subjekti i rivlerësimit ushtronte detyrën e këshilltares ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese dhe, për rrjedhojë, referuar fjalisë së parë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës, në cilësinë e këshilltarit ligjor (në detyrë) pranë Gjykatës Kushtetuese, znj. Valbona Bala (Pajo), mori statusin e subjektit të rivlerësimit *ex officio* (dhe jo atë të subjektit të rivlerësimit me kërkesë, sipas nenit 179/b, pika 4, fjalia e dytë e

<sup>14</sup> Sipas shkresës së Gjykatës Kushtetuese nr. {\*\*\*} prot., datë 27.06.2018, drejtuar Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

<sup>15</sup> Referuar Qendrës së Botimeve Zyrtare, ligji nr. 76/2016 ka hyrë në fuqi më datë 11 gusht 2016 (15 ditë nga botimi i ligjit në Fletoren Zyrtare nr. 138, datë 27 korrik 2015).

Kushtetutës<sup>16</sup>), të drejtat dhe detyrimet e të cilit parashikoheshin në dispozitat kushtetuese dhe në ligjin nr. 84/2016, i cili hyri në fuqi më datë 08.10.2016. Si pasojë e pezullimit nga Gjykata Kushtetuese, afatet lidhur me të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të rivlerësimit u pezulluan nga data 25.10.2016 deri më datë 19.01.2017, datë kjo e cila e gjeti subjektin në të njëjtën detyrë funksionale.

**21.2** Akti i dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit nga detyra e këshilltarit ligjor, tashmë pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor të Gjykatës Kushtetuese mban datën 31 mars 2017, datë kjo që përkon me përfundimin e afatit ligjor prej 3 muajsh për të dhënë dorëheqjen nga detyra, sipas nenit 56 të ligjit nr. 84/2016. Në shqyrtim të këtij akti dorëheqjeje, në të cilin shprehet vullneti i subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Bala (Pajo) për të mos ushtruar në vijim detyrën e saj si këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese, trupi gjykues arrin në përfundimin se, pavarësisht faktit që dorëheqja nga detyra është dhënë më datë 31.03.2017, ajo nuk vlerësohet si dorëheqje nga detyra në bazë të nenit 56 të ligjit nr. 84/2016, dhe nuk duhet të trajtohet si e tillë, jo vetëm sepse subjekti i rivlerësimit vullnetin e saj për t'u dorëhequr nga detyra e ka shprehur në mënyrë eksplicite me efekt të mëvonshëm në kohë nga data e nënshkrimit të aktit, por edhe për faktin që subjekti nuk rezulton të ketë ndjekur procedurën e parashikuar nga dispozita e sipërcituar, çka, në vlerësim të trupit gjykues, konfirmon faktin që subjekti nuk ka pasur qëllim të përfitojë nga e drejta që i jepte neni 56 i ligjit nr. 84/2016.

**21.3** Akti i dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, i bërë efektiv më datë 30.04.2017, sipas të cilit që nga data 01.05.2017, znj. Valbona Bala (Pajo) nuk do të mund të ushtronte detyrën si këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese, sjell si pasojë humbjen e statusit si subjekt rivlerësimi (*ex officio*) në kuadër të përcaktimit kushtetues të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës, si dhe pamundësinë e realizimit të qëllimit të procesit të rivlerësimit, duke pasur parasysh që, referuar nenit 165 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 58, pika 1, nënparagrafët “a”, “b”, “c” të ligjit nr. 84/2016, qëllimi për kryerjen e procesit të rivlerësimit, i parashikuar në pikën 1 të nenit 179/b të Kushtetutës realizohet, përfundimisht, nëpërmjet konfirmimit në detyrë apo shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit (pa marrë në konsideratë pezullimin shoqëruar me edukim të detyrueshëm, duke qenë se kjo është masë e përkohshme, e cila në vijim do të përfundojë me vendimmarrje të organit rivlerësues për konfirmim në detyrë apo shkarkim). Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se dorëheqja e subjektit të rivlerësimit Valbona Bala (Pajo), e cila ka ndodhur pas afatit të parashikuar nga neni 56 i ligjit nr. 84/2016 dhe përpara përfundimit të procesit të rivlerësimit, konsiston në dorëheqje nga detyra sipas procedurës së nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se Komisioni, në kundërshtim me parashikimet kushtetuese lidhur me institutin e dorëheqjes nga detyra në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, si dhe me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit<sup>17</sup> dhe orientimin e dhënë në trajtimin prej tij të çështjeve

<sup>16</sup> Në nenin 179/b të Kushtetutës, në pikën 4, fjalia e dytë përcaktohen si subjekte të cilët mund t'i nënshtrohen procesit të rivlerësimit me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit, ish-gjyqtarët, ish-prokurorët dhe ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet.

<sup>17</sup> Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 1/2018 (JR), datë 11.06.2018 dhe nr. 5/2018 (JR), datë 10.09.2018.

të ngjashme, nuk ka parashikuar në pjesën urdhëruese të vendimit ndalimin e ushtrimit të funksioneve nga subjekti i rivlerësimit për periudhën 15-vjeçare, sipas parashikimeve të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në sistemin e drejtësisë për një periudhë 15-vjeçare është parashikuar nga kushtetutëbërësi si pasoja juridike që i atribuohet ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, si pasojë e dorëheqjes nga detyra në kuptim të nenit G të Aneksit të Kushtetutës dhe, si e tillë, ajo duhet të gjejë pasqyrim në vendimmarrjet e Komisionit, sipas kësaj dispozite kushtetuese.

**21.4** Vullneti për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit sipas përcaktimit të tij në dispozitat kushtetuese dhe ligjin nr. 84/2016, shprehet vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit. Në momentin që subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Bala (Pajo), vendosi me vullnetin e saj të lirë të ndërpriste detyrën funksionale (këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese) që e bënte atë subjekt të procesit të rivlerësimit *ex officio*, duhet të merrte parasysh edhe pasojën ligjore që sillte dorëheqja e saj nga detyra në ecurinë e procesit të rivlerësimit, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se në komunikimet me Komisionin, ndërkohë që kishte humbur funksionin që e bënte subjekt të procesit të rivlerësimit, ajo nuk ka shprehur vullnet për t’iu shmangur procesit të rivlerësimit, nuk vlerësohet nga trupi gjykues si shkak i ligjshëm për moszbatimin e plotë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Për më tepër, qëndrimi i subjektit të rivlerësimit para trupit gjykues, duke pranuar nga njëra anë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, sipas paragrafit 1 të nenit G dhe duke kërkuar nga ana tjetër, mospërcaktimin në pjesën arsyetuese të vendimit të ndalimit të parashikuar në paragrafin 2 të të njëjtit nen të Kushtetutës, përveçse vjen ndesh me parashikimin e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, vë në dyshim vullnetin real për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit.

**21.5** Në arritjen e konkluzionit të mësipërm, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe mendimin e vëzhguesit ndërkombëtar, të paraqitur pranë Komisionit në bazë të nenit B, pika 3, shkronja “b” e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, i cili, në vijim të analizës së tij ligjore mbi situatën faktike të subjektit në fjalë, në mënyrë të përmbledhur konkludon se Komisioni nuk ka kompetenca për të vazhduar procesin e rivlerësimit, sepse subjektit të rivlerësimit i mungon cilësia subjektive, e cila është një parakusht për procesin e rivlerësimit, duke qenë se subjekti nuk bën më pjesë as në kategorinë e subjekteve që rivlerësohen *ex officio* dhe as të atyre në mënyrë vullnetare, pasi nuk e ka statusin subjektiv, sipas nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës. Sipas vëzhguesit ndërkombëtar, procesi i rivlerësimit nuk mund të vazhdohet pas dorëheqjes së znj. Bala, pavarësisht se ajo i kërkon shprehimisht Komisionit ta bëjë këtë. Sipas vëzhguesit ndërkombëtar, kërkesa që vjen nga një individ nuk mund t’i atribuojë kompetenca rivlerësimi Komisionit (të cilat janë të një natyre publike). Gjithashtu vëzhguesi ndërkombëtar shprehet se nuk mund të pretendohet që për shkak të dorëheqjes, znj. Bala të konsiderohet si “ish-këshilltare ligjore”, pasi ky interpretim është në kundërshtim me paragrafin e dytë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, qëllimi i të cilit do të cenohej nëse subjektet e rivlerësimit *ex officio*, pas dorëheqjes do të kishin të drejtë të ktheheshin në “subjekte rivlerësimi vullnetare”. Për rrjedhojë, subjekte rivlerësimi vullnetare do të jenë vetëm ata të cilët kanë qenë ish-gjyqtarë ose ish-këshilltarë ligjorë, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese. Në përfundim, sipas vëzhguesit

ndërkombëtar, procesi i rivlerësimit për subjektin në fjalë duhet të ndërpritet në zbatim të plotë të dispozitave të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

22. *Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me moszbatimin e pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës dhe pretendimit që kjo masë konsiston në një kufizim të nenit 49 të Kushtetutës, i cili në rastin e saj është joproporcional, trupi gjykues në vlerësimin e këtij pretendimi mban në konsideratë qëndrimin që ka mbajtur Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017 (V-2/17)<sup>18</sup> ndaj pretendimit të kërkuarit për cenim të së drejtës së ankimit të subjekteve të rivlerësimit, si një kufizim joproporcional i të drejtave kushtetuese që bie ndesh me nenin 17 të Kushtetutës. Në këtë vendim Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar: *Vlerësimi nëse ky kufizim është proporcional apo jo nuk mund të jetë objekt i këtij gjykimi, për sa kohë që ai jo vetëm është vendosur në rang kushtetues, por edhe sepse Gjykata nuk ka juridiksion për vlerësimin në themel të këtyre dispozitave, të cilat janë inkorporuar në Kushtetutë me anë të një ligji rishikues*<sup>19</sup>.*

22.1 Në këtë kuptim, trupi gjykues arrin në përfundimin se për sa kohë dorëheqja e subjektit të rivlerësimit përmbush kriteret e përcaktuara në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, atëherë pasoja juridike që i atribuohet situatës faktike të parashikuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës do duhet të zbatohet në tërësinë e saj<sup>20</sup>. Vlerësimi nëse ky kufizim është proporcional apo jo nuk mund të jetë objekt i këtij gjykimi, për sa kohë që ai është një parashikim kushtetues.

23. Në përfundim të shqyrtimit të të gjitha shkaqeve të ankimit të ngritura respektivisht nga Komisioneri Publik dhe subjekti i rivlerësimit, pas verifikimit të situatës faktike nëpërmjet çmuarjes së provave të administruara gjatë procesit të hetimit nga Komisioni, dëgjimit të parashtrimeve të palëve në proces, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm,

**trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,  
bazuar në analizën e mësipërme, arrin në këto konkluzione:**

24. Lidhur me ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Valbona Bala (Pajo), nga Komisioni sipas vendimit nr. 65, datë 13.09.2018, trupi gjykues e gjen të bazuar në faktet e provuara dhe në ligj ankimin e Komisionerit Publik dhe të pabazuar ankimin e subjektit të rivlerësimit.
25. Shkaqet e ankimit që lidhen me shkelje procedurale të cilat u konstatuan edhe nga Kolegji, janë shqyrtuar prej tij në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, duke u korrigjuar përmes gjykimit në seancë publike dhe nuk përbëjnë shkak për cenimin e vendimit të Komisionit.

<sup>18</sup> *Vendimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me kërkesën e “Jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, anëtarë të grupit parlamentar të Partisë Demokratike”, me objekt “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i ligjit nr.84/2016, datë 30.08.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

<sup>19</sup> *Për më tepër, shih paragrafin 68 të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 18.01.2017 (V-2/17).*

<sup>20</sup> *Këtë qëndrim Kolegji ka mbajtur edhe në vendimmarrje të mëparshme (shih vendimin e Kolegjit nr. 1/2018 (JR) ), sipas së cilës Komisioni orientohet që, përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit sipas nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.*

26. Për rrjedhojë, kërkimi i Komisionerit Publik për ndryshimin e vendimit nr. 65, datë 13.09.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duhet pranuar dhe vendimi i sipërcituar të ndryshohet pjesërisht.

**PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Ndryshimin e vendimit nr. 65, datë 13.09.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit si më poshtë.
  - Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Valbona Bala (Pajo).
  - Subjekti i rivlerësimit Valbona Bala (Pajo) nuk mund të emërohet gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 25.07.2019, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**  
*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Luan DACI**  
*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**  
*nënshkrimi*

**RELATOR**

**Sokol ÇOMO**  
*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Ina RAMA**  
*nënshkrimi*